



## Sistem i ri modern për shërbime më të mira

### Konsumatorë të nderuar,

EVN Macedonia prej 1 maj të vitit 2010 do të implementojë sistem të ri modern për leximin, përpunimin dhe pagesën e energjisë së shpenzuar elektrike.

Për shkak të kohës së nevojshme për integrimin e sistemit të ri, në fillim të muajit prill do t'ju dorëzohen dy fatura për energji elektrike në formën e deritanishme – njëjloj si edhe gjatë kohës së pushimeve vjetore.

Llogaritjet dedikohen për vlerat e lexuara për muajin mars dhe vlerat e prognozuara për muajin prill. Fatura për muajin prill, edhe pse e dorëzuar para kohe, afati i pagesës do të jetë njëjloj si afati i rregullt deri më 15 maj të vitit 2010.

EVN Macedonia aplikon sistemin e ri për llogaritje me të vetmin qëllim – shërbime më të mira, përparësi dhe beneficione:

- Fatura e re do të jetë më e qartë dhe më detajore, me pamje të re moderne;
- Dorëzimi i të gjitha faturave do të kryhet nga ana e Postave të Maqedonisë, në adresën sipas zgjedhjes së konsumatorit, me mundësi në një adresë të arrijnë fatura për më tepër matës të energjisë elektrike;
- Vend-pagesat e EVN Macedonia do të ofrojnë numër të shtuar të shërbimeve. Në cilindo qytet, pavarësisht vendbanimit, konsumatorët do të mund t'i paguajnë faturat për energji elektrike, të pranojnë kopje dhe të bëjnë korrigjime të të njëjtave, si dhe të pranojnë informata të ndryshme.

Fatura e parë e sistemit të ri për muajin maj, tek numri i madh i konsumatorëve do të dedikohet për periudhë llogaritëse më të shkurtër se një muaj. Duke filluar që nga muaji i ardhshëm, pa përjashtime, energjia e llogaritur si edhe deri tani do të dedikohet për periudhën e llogaritur për një muaj.

Ju lutemi nëse për çfarëdolloj arsye ndodh që mos të ju arrijë fatura për energji elektrike, drejtohuni në EQK më të afërt dhe kërkoni kopje të faturës (në pajtim me kushtet për furnizim me energji elektrike neni 51 alinea 2).

EVN Macedonia gjithmonë në qendër të aktiviteteve të veta ka konsumatorët e vet, për këtë arsye ju faleminderohemi për mirëkuptim gjatë periudhës në vijim derisa zgjat procesi i implementimit përfundimtar të sistemit të ri të llogaritjes.

Për të gjitha pyetjet shtesë na kontaktoni nëpërmjet Qendrës për Marrëdhënie me Konsumatorë në numrin 0890 12345, në dispozicion për ju 24 orë, 7 ditë në javë.

[info@evn.com.mk](mailto:info@evn.com.mk)

për informata: 0890 12345

për defektet: 0890 88888

**EVN**  
macedonia 